VENDIM
Nr. 726, datë 20.11.2024

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 61, DATË 7.2.2024, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E KËRKESAVE E TË KRITEREVE QË DUHET TË PLOTËSOJNË *STARTUP*-et DHE LEHTËSUESIT E *STARTUP*-eve, TË PROCEDURAVE E TË AFATEVE, SI DHE TË RREGULLAVE PËR PËRBËRJEN E KOMISIONIT TË VLERËSIMIT DHE ANKIMIT, KRITEREVE, PROCEDURËS SË PËRZGJEDHJES E TË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË TYRE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 3 e 4, të nenit 14, të ligjit nr. 25/2022, "Për mbështetjen dhe zhvillimin e *startup*-eve", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 4, të kreut V, të vendimit nr. 61, datë 7.2.2024, të Këshillit të Ministrave, togfjalëshi "... brenda 10 (dhjetë) ditëve ..." zëvendësohet me "... brenda 30 (tridhjetë) ditëve ...".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku